



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1503/6 prot

Datë 20.06.2024

V E N D I M
Nr. 716/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.06.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:	Vendim për mbylljen e çështjes, mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Si & Co Company” SHPK, për procedurën e prokurimit “ <i>Procedurë e hapur</i> ” me Nr. REF-07681-06-01-2024, me objekt “ <i>Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i> ”, me fond limit 5,567,043 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.06.2023, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.
Autoriteti Kontraktor:	Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, NR.3, 1001, Tiranë.
Ankimues:	“Si & Co Company” SHPK, me NIPT (L21420002F) dhe adresë: Rruga “Qemal Stafa”, Ndërtesa nr. Pasurie 3/252-N7, ZK.8140, dyqani D-07, Tiranë
Baza Ligjore:	Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “ <i>Për</i>

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-07681-06-01-2024, me objekt “Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 5,567,043 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 19.06.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/4176 datë 07.06.2024 dhe me nr. 1503/2024 protokoli, datë 10.06.2024, si dhe ankimi elektronik me nr. A/2023/4178 datë 07.06.2024 dhe me nr. 1503/1 protokoli, datë 10.06.2024, i operatorit ekonomik “Si & Co

Company” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr.393/5 prot., datë 14.06.2023 me objekt “Dërgohet vendim mbi shqyrtimin e ankesës”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar Vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 393/4 prot., datë 13.06.2023. Konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës, si më poshtë vijon:

[...]

“...Nga sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë edhe Vendimin Nr. 240/2023 datë 03.04.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa qëndron dhe ngarkohet Njësia e Prokurimit, që me anë të një shtojce të bëjë ndryshimet përkatëse dhe ti ngarkojë ato në SPE në dispozicion të të gjithë OE të interesuar për të marrë pjesë në procedurë. Për këto arsye [...] Vendosën: Pranimin e plotë të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Si & Co Company” SHPK [...].”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr.393/5 prot., datë 14.06.2023, me objekt “Dërgohet vendim mbi shqyrtimin e ankesës”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 393/4 prot., datë 13.06.2023. Konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...]

“...Nga sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë edhe Vendimin Nr. 240/2023 datë 03.04.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa qëndron dhe ngarkohet Njësia e Prokurimit, që me anë të një shtojce të bëjë ndryshimet përkatëse dhe t'i ngarkojë ato në SPE në dispozicion të të gjithë OE të interesuar për të marrë pjesë në procedurë. Për këto arsye [...] Vendosën: Pranimin e plotë të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Si & Co Company” SHPK [...].”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e

tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr.393/5 prot., datë 14.06.2023, me objekt “Dërgohet vendim mbi shqyrtimin e ankesës”, dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht, Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115, pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Si & Co Company” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-07681-06-01-2024, me objekt “Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 5,567,043 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 19.06.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Si & Co Company” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

